




BARAZIA GJINORE

Broshurë informuese



Kjo Broshurë e Barazisë Gjinore synon të sigurojë informacione të përgjithshme mbi përkatësinë gjinore (gender) dhe rëndësinë e saj, situatën në Shqipëri dhe promovimin e fuqizimit të grave.

Barazia gjinore është më shumë se një qëllim në vetvete.

Është shumë e rëndësishme ngritja e kapaciteteve të grave për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre aktive në proceset politike, sociale dhe ekonomike si dhe për të iniciuar dialogun gjinor.

1. REALIZIMI I BARAZISË GJINORE ËSHTË NJË ANGAZHIM THELBËSOR I TË GJITHË SHOQËRISË. PSE?

- Sepse barazia midis grave dhe burrave është ajo që duhet, është e drejtë dhe e saktë.
- Qëndron në zemër të zhvillimit njerëzor dhe të të drejtave të njeriut.
- Dhe sepse pabarazia gjinore është një pengesë për përparimin, një pengesë në rrugën e zhvillimit njerëzor.

2. ÇFARË ËSHTË BARAZIA GJINORE DHE PSE KA RËNDËSI?

Parimi i barazisë është një e drejtë themelore dhe thelbësore e njeriut. Ajo njihet si e tillë në të gjitha instrumentet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Barazia gjinore nuk ka të bëjë vetëm me gratë, ashtu siç mendohet shpesh. Barazia gjinore më tepër se të përqendrohet në ose gra ose burra, merr në konsideratë situatën e të dy palëve dhe synon të adresojë çështjet që prekin në mënyrë të pabarabartë, si gratë ashtu edhe burrat.

Barazia gjinore nënkupton sigurimin e kushteve të barabarta për gratë dhe burrat që të gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore. Ajo nënkupton, gjithashtu, sigurimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat që të kontribuojnë në zhvillimet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në shoqërinë e tyre dhe të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga rezultatet. “Barazia gjinore nuk do të thotë që burrat dhe gratë të bëhen të njëjtë, por që mundësitë dhe shanset e tyre të jetës janë të barabarta.”

3. PSE NA DUHET BARAZIA GJINORE?

Barazia është një parakusht thelbësor për zhvillimin njerëzor. Është shumë e vështirë të sigurohet një shpërndarje e barabartë e burimeve pa pjesëmarrjen e grave në të gjitha sferat dhe nivelet e shoqërisë në numra përfaqësues. Pamundësia e grave për t'i çuar interesat e tyre në një nivel më të lartë rezulton në lënien e disa çështjeve të rëndësishme të paadresuara. Mungesa e grave nga vendimmarrja politike pengon një pjesë të konsiderueshme të shoqërisë nga individi, në përftimin e të drejtave të barabarta të burrave dhe grave.

Dispozitat e Kartës në lidhje me të Drejtat e Barabarta të Grave janë përmirësuar dhe zhvilluar më tej në një numër të madh instrumentesh ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.



A EKZISTON FENOMENI I PABARAZISË GJINORE NË SHOQËRINË SHQIPTARE?

Nga pikëpamja juridike, gratë në Shqipëri gëzojnë garanci kundër diskriminimit: legjislacioni bazohet në parimin e të drejtave të barabarta dhe barazia garantohet sipas Kushtetutës. Një sërë konventash ndërkombëtare kulturore, shoqërore, klasore, ekonomike ose kufizime fetare. Meqenëse dhuna me bazë gjinore është një problem në të gjithë globin, është bërë një shqetësim për të gjitha shtetet. Ulja me efektshmëri e trafikimit të grave dhe vajzave –një formë tjetër dhune është bërë një tjetër shqetësim ndërkombëtar.



Në Shqipëri, si në shumë vende të tjera, dhuna në familje konsiderohet çështje private; prandaj kryesisht kalon pa u vënë re dhe nuk raportohet. Ndërkohë, shifrat e nxjerra nga hulumtimet e bëra nga disa OJF janë alarmante. Dhuna zakonisht perceptohet vetëm e natyrës fizike, megjithatë, është shumë më tepër se kaq. Llojet psikologjike të dhunës janë shumë më të përhapura sesa ato fizike dhe seksuale.

Mungesa e aksesit të grave në informacion, ndihmë dhe mbrojtje juridike si edhe zbatimi efektiv i ligjit i përjetëson fenomenet.



PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË FUQIZOHEN GRATË, DHE VEÇANËRISHT GRATË RURALE?

Gratë, veçanërisht në sektorin rural, përballen me një sërë barrierash politike dhe kulturore që i kufizojnë ato të realizojnë potencialin e tyre. Kjo jo vetëm që vazhdon të pengojë rritjen ekonomike duke parandaluar artificialisht një pjesë të madhe të fuqisë punëtore për të hyrë plotësisht në treg, por është, gjithashtu, një shkak i varfërisë kronike pasi familjet e udhëhequra nga gratë e gjejnë veten me pak mundësi dhe familjet e udhëhequra nga meshkujt me të ardhura jo të mjaftueshme.

Gratë rurale janë mbështetja kryesore e padukshme e rezistencës dhe qëndrueshmërisë së komunitetit.

Gratë rurale janë kontribuesit kryesorë në prodhimin bujqësor, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e klimës, sipërmarrjen dhe shtetësinë. Për fat të keq, kontributi aktiv dhe përpjekja e grave rurale nuk njihet dhe potencialet e tyre të plota nuk shfrytëzohen.

Kur gratë janë të fuqizuara, ato, nga ana tjetër, kontribuojnë në të ardhurat e familjes së tyre dhe bëhen udhëheqëse aktive të ndryshimit në komunitetet e tyre. Nuk duhen mohuar shprehjet që “nëse mbështetni një grua, ju mbështetni një komunitet” dhe “një investim 1 dollar për një grua është një investim i zgjuar”. Kur ajo fuqizohet, tërë brezi dhe familja e saj fuqizohen.

Fuqizimi dhe zhvillimi i grave është një detyrë e vështirë, por e lehtë nëse të gjithë në ndërmarrim pak veprime me vlerë dhe ndikim gjatë gjithë jetës si individë, organizata zhvillimi, agjensi qeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare, kompani private dhe publike. Kjo do të çojë në ndikimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe zhvillimin e grave.

PRA, SI MUND TË FUQIZOHEN GRATË RURALE NË MËNYRË TË QËNDRUESHME?

ARSIMIMI DHE FORMIMI I TË RRITURVE: Investimi dhe ngritja e kapaciteteve të grave rurale do të përmirësojë aftësitë e tyre të biznesit, sociale, ekonomike dhe financiare. Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i të rriturve varion nga ofrimi i arsimimit të të rriturve deri te formimi për aftësitë jetësore dhe sociale. Arsimimi dhe formimi i të rriturve (arsimimi mbi sipërmarrjen) është një industri e madhe dhe mund të kanalizohet për të ndihmuar gratë rurale që të fuqizohen. Një nga pengesat më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm të grave është mungesa e qasjes së tyre në arsimimin dhe formimin cilësor të të rriturve. Kur gratë kanë qasje në mundësi formimi të zhvillimit cilësor tërësor personal, emocional dhe sipërmarrës, ato do të jenë të fuqizuara të flasin për veten e tyre. Ato bëhen të sigurta dhe mund të flasin kundër çdo abuzimi dhe dhune.

SHPREHITË PROFESIONALE DHE BIZNESET: Gratë rurale kërkojnë mënyra të ndryshme për t'u fuqizuar përmes shprehive praktike, sipërmarrjes dhe zgjerimit të mikrobiznesit. Ne mund të kontribuojmë që t'i ndihmojmë gratë rurale të fitojnë formim të drejtpërdrejtë të aftësive profesionale ose mundësi zgjerimi të ideve të biznesit duke u siguruar atyre mjetet kryesore për të filluar, funksionuar, ndërtuar dhe zgjeruar bizneset e tyre. Me kalimin e viteve, gratë rurale janë angazhuar në bujqësi, peshkim dhe tregti. Agjencitë mund të hartojnë programe për zhvillimin e grave që janë të përqendruara në ofrimin e programeve për shprehitë bazë që mund t'i ndihmojnë ato të hyjnë në tregje për të shitur produktet e tyre bujqësore; të kuptojnë zinxhirin e vlerës së industrisë së tyre dhe bazat e menaxhimit dhe funksionimit të biznesit të vogël.

QASJA NË LEHTËSIRAT FINANCIARE: Gratë rurale vazhdimisht janë duke kërkuar mënyra të ndryshme për të përfutur mikrokredi, mjete bujqësore, menaxhim biznesi dhe mjete pune. Një grua që është angazhuar të punojë, do të bëjë më shumë dhe do t'i shumëfishojë përpjekjet e saj nëse ajo ka qasje në mjetet bazë që të ketë efikasitet dhe produktivitet. Fokusi i hartimit të projektit ose programit për fuqizimin e grave duhet të jetë i tillë që t'i ndihmojë gratë të përdorin hua pa interes, mjetet bazë të biznesit dhe pajisjet për fermë. Një nga zgjidhjet për krijimin e efektit shumëfishues që ndikon në rritjen e ndërtimit të bizneseve të vogla të qëndrueshme në komunitete është të ndihmohen gratë të kenë qasje në mjetet bazë lehtësuese për angazhimin e tyre të përditshëm.

SHËNDETI: Gratë janë kryesisht të prekshme nga çdo formë e problemeve shëndetësore në komunitete të ndryshme. Ato përballen me të gjitha format e sfidave shëndetësore. Ato janë bartëse të epidemive të sëmundjeve të transmetueshme vdekjeprurëse. Ekziston një shkallë e lartë e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave, HIV / AIDS dhe sëmundje të tjera vdekjeprurëse që shkaktohen nga kjo e dyta në të gjithë botën. Individët, organizatat dhe agjencitë mund të hartojnë projekte që përqendrohen në sigurimin e një kujdesi shëndetësor të përbalueshëm dhe formim për gratë lidhur me jetesën e shëndetshme, marrjen dhe përdorimin e ujit të pastër, mbajtjen pastër dhe gjelbër të mjedisit.



Investimi në ndërmarrje të vogla rurale në vendet në zhvillim është jashtëzakonisht sfidues. Angazhimi për fuqizimin e grave mund t'i shtohet këtij kompleksiteti pasi kandidatët për investime duhet të vlerësohen përkundrejt një grupi tjetër kriteresh. Për të qenë të suksesshëm në promovimin e përparësive të investimit për fuqizimin e grave, duhet të jenë të qarta kufizimet dhe kostot e (pa)pranueshme. Kjo mund të shkojë deri aty sa të vendoset që të investohet ekskluzivisht në biznese të drejtuara nga gratë ose vetëm biznese të grave.

Rëndësia e bërjes së këtyre qëllimeve dhe angazhimeve të qarta nuk mund të mbivlerësohet: është e rëndësishme që menaxherët e fondeve, vendimmarrësit e investimeve, stafi dhe këshilltarët të kenë një mandat të qartë dhe kriteret e qarta për të vlerësuar se si një ndërmarrje e veçantë të mund të kontribuojë në arritjen e fuqizimit të grave.

Normat sociale dhe kulturore janë përgjegjëse për shumë nga pengesat për fuqizimin e grave. Është e rëndësishme të kuptohet se si këto ndikojnë në ndërmarrje dhe aftësinë e saj për të krijuar mundësi gjithnjë e më të qëndrueshme ekonomike për gratë. Një investim në mësimet e gatimit për burrat, për shembull mund të çojë në një rishpërndarje të punëve të kujdesit pa pagesë në nivelin shtëpiak, që nga ana tjetër mund të krijojë kohë për gratë që të angazhohen me ndërmarrjen. Për të adresuar këto çështje të ndjeshme brenda një konteksti të veçantë komunitar dhe kulturor është thelbësore që të identifikohen dhe të punohet me partnerë (lokalë).



ARSIMIMI DHE FORMIMI I TË RRITURVE

Kur gratë kanë qasje në mundësi formimi të zhvillimit cilësor tërësor personal, emocional dhe sipërmarrës, ato do të jenë të fuqizuara të flasin për veten e tyre.



SHPREHITË PROFESIONALE DHE BIZNESET

Duke u siguruar atyre mjetet kryesore për të filluar, funksionuar, ndërtuar dhe zgjeruar bizneset e tyre.

QASJA NË LEHTËSIRAT FINANCIARE

Një grua që është angazhuar të punojë do të bëjë më shumë dhe do t'i shumëfishojë përpjekjet e saj nëse ajo ka qasje në mjetet bazë që të ketë efikasitet dhe produktivitet.



SHËNDETI

Individët, organizatat dhe agjensitë mund të hartojnë projekte që përqendrohen në sigurimin e një kujdesi shëndetësor të përballueshëm dhe formim për gratë lidhur me jetesën e shëndetshme, marrjen dhe përdorimin e ujit të pastër, mbajtjen pastër dhe gjelbër të mjedisit.





MBËSHTETJA DHE INVESTIMI NË EKIPE DREJTUESE: PROMOVIMI I REKRUTIMIT TË GRAVE SI MENAXHERE / STAFI KRYESOR.

Gratë në të gjithë botën janë ende të nënpërfaqësuar në pozicionet menaxheriale. Investitorët mund të luajnë një rol kryesor për të promovuar rekrutimin e menaxhereve femra dhe stafit kryesor. Kjo ka qenë një qasje veçanërisht efektive pasi menaxherët femra jo vetëm që kontribuojnë në ndryshimin e perceptimit të roleve gjinore, por, gjithashtu, janë në gjendje të identifikojnë mënyra të reja krijuese për të angazhuar dhe fuqizuar gratë e tjera në komunitetet e tyre.

Investimi tek bizneset e vogla (start-ups) të udhëhequra nga gratë dhe iniciativat e afërta me biznesin kryesor.

Një mënyrë e efektshme për të promovuar fuqizimin e grave, veçanërisht në tregje ose zinxhirët e vlerës që tradicionalisht janë dominuar nga meshkujt, është të investohet në sipërmarrje të vogla që janë të afërta me biznesin kryesor. Kjo mund të jetë një serë e drejtuar nga një grua për të prodhuar fidanë që më pas mund të shiten tek ndërmarrja kryesore ose në një dyqan ku fermerët mund të blejnë fara dhe produkte bujqësore, etj.

Në mënyrë tipike këto start-ups promovojnë veprimin kolektiv të grave që mund të jetë një hap i rëndësishëm drejt fuqizimit të shtuar. Ka një rekord inkurajues për investime në këto lloje biznesesh, ku shumica bëhen fitimprurës në më pak se 18 muaj.

Këto qasje janë reciprokisht forcuese dhe akoma më me efekt kur kombinohen. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave tani është një përparësi globale.

Sfida është shumë e madhe dhe po ashtu janë ndikimet pozitive që do të ketë kjo në zbutjen e varfërisë dhe ekonominë globale.

Si pjesë e kësaj përpjekje globale, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të luajnë një rol kryesor dhe udhëheqës duke krijuar mundësi të reja për fuqizimin ekonomik të grave. Të dhënat dhe hulumtimet tregojnë se rritja e barazisë gjinore nuk ndihmon vetëm ekonominë në tërësi, por gjithashtu, ka përfitime të prekshme për ndërmarrjen individuale duke e bërë këtë një rast fitues për investorët e orientuar drejt ndikimit.



2019. Të drejta të rezervuara.

Unioni Amaro Drom

Krijoi: Anjeza Kolami

Për më shumë informacion: kolamianjeza@yahoo.com

IMAZHET:

Të gjitha imazhet në këtë broshurë nuk janë e drejta e krijuesit.

Burimi i tyre është unsplash.com and pexels.com